



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë të nenit 22 paragrafi dhe nenit 23 paragrafi 1 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave dhe në përputhje me nenit 40 paragrafi 3 nga Rregullorja për punë e Komisionit shtetëror (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, numër 12/2019), Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit (KSHPK), duke vepruar për Kërkesën për mendim nga SHFK "Goce Dellçev" Kavadar, në vazhdimin e seancës së 46-të të mbajtur me datë 12 shkurt 2021 morri

VENDIM

Lënda e formular në bazë të Kërkesë së dorëzuar për mendim nga SHFK Goce Dellçev nga Kavadari me numër 09-3524/1 me datë 12.07.2019 për atë se vallë ekziston gjendja e konfliktit të interesave për shkak se në Këshillin e shkollës anëtari është bashkëshorti i, e punësuar në shkollë me kontrat në vepër në kohë të caktuar, **NDËRPRITET.**

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit dha Mendim në bazë të Kërkesës së parashtruar dhe vërtetoi se në rastin konkret i cili është emëruar për anëtar të Këshillit të shkollës dhe bashkëshort i e punësuar në shkollë me kontrat në vepër në kohë të caktuar. Në përputhje me nenin 77 paragrafi 1 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave nuk mund të kryen funksion në këshillin e shkollës, përshkak të së cilës i rekomandohet SHFK se është e obligueshme që të ndërmer hapa në drejtim të menjanimit të konfliktit të interesave në afat prej 15 ditë nga dita e pranimit të shkrimit dhe deri tek Komisioni shtetëror të dorëzon dëshmi për veprimin ose procedurën e(dërheqjes së tij nga funksioni anëtar i Këshillit të shkollës).

Deri tek Komisioni shtetëror është dorëzuar Vendimi për shkarkim të nga anëtar i këshillit të shkollës, me çka është arritur efekti nga veprimi i Komisionit shtetëror.

Lënda me numër 09-3524/1 me datë 12.07.2020 të mbyllet dhe të arkivohet.

SQARIM

Lënda me numër 09-3524/1 me datë 12.07.2019 e formular në bazë të Kërkesë së dorëzuar për mendim nga SHFK me numër 09-3524/1 me datë 12.07.2019 për atë se vallë ekziston konflikt i interesave për arsye se në Këshillin e shkollës anëatri..... është bashkëshort i e punësuar në shkollë me kontrat në vepër në kohë të caktuar.

Deri tek Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit, SHFK dorëzoi Kërkesë për mendim me të cilët tregohet se me datë 10.07.2019, është pranuar vendim nga Këshilli i Komunës për shkarkim dhe emërim të përfaqësuesve të Komunës për anëtarë të Këshillit të shkollës në SHFK Për përfaqësues të

komunës në Këshillin e shkollës SHFK emërohen personat dhe për mandat prej tre vitesh.

Anëtari i këshillit të shkollës është edhe bashkëshort i e cila kohë më të gjatë është e punësuar në atë shkollës i mësimdhënës për gjuhëna maqedone me kontratë në kohë të caktuar.

Komisioni shtetëror pas shqyrtimit të Kërkesës për mendim dorëzuar nag SHFK dhe në përputhje me nenin 77 paragrafi 1 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave ka konstatuar ekzistim të konfliktit të intersave, me çka rekomandon që të ndërmerren hapa të obligueshme në drejtim të menjanimit të gjendjes së shkaktuar në afat prej 15 ditë llogaritur nga dita e pranimit të shkrimit, dhe njëherit në shtojcë të dorëzohen edhe dëshmi për veprimin e personit (dorëheqja e tij nga funksioni i anëtarit të Këshillit të shkollës).

Gjithashtu, Komisioni shtetëror tregon se në përputhje me nenin 96 paragrafi 1, në lidhje me nenin 126 paragrafi 1 alinea 11 nga Ligji për shkollim fillore, Byroja, Këshilli i prindërve ose Inspektorati shtetëror i arsimit mund të ngysin iniciativë deri tek këshilli i shkollës për rishqyrtim të aftësisë së mësimdhënësve për realizimin e detyrave të punës, të cilat gjatë realizimit të procesit edukativo-arsimor nuk tregojnë rezultate të kënaqshme, me çka këshilli i shkollës mund të parashtron propozim deri tek drejtori për ndërprerje të kontratës së punës për mësimdhënësit.

Nga ana tjetër, në përputhje me nenin 46 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave "personat që janë në lidhje të afërt me personat zyrtar, për të cilët me arsye llogariten se ekziston konflikt i interesave që i ndërlidhë me personat zyrtar, nuk mund të bëjnë mbikqyrje supervizore ose kontrole mbi punën e tyre".

Personi si anëtar i Këshillit të shkollës SHFK nuk mund të bënë punë supervizori ose kontroll mbi punën e personit e punësuar në shkollën e njëjtë dhe bashkëshorte e tij.

Përshkak të asaj se SHFK në afatin e caktuar me ligj nuk dorëzoi përgjigje të mendimit të Komisionit shtetëror, gjegjësisht nuk ka ndërmarrë veprime në drejtim të menjanimit të gjendjes së konstatuar të konfliktit të interesave, Komisioni shtetëror dërgoi urgjencë me numër 09-540/2 me datë 14.09.2020, me të cilën edhe njëherë tregon për nevojën që të ndërmarrin veprime në drejtim të menjanimit të gjendjes së konfliktit të interesave.

Pas dorëzimit të urgjencës, deri tek Komisioni shtetëror është dërguar përgjigje e urgjencës me numër 09-540/2 me datë 08.10.2020, gjegjësisht Vendim nga Këshilli i komunës për ndërprerje të mandatit të anëtari të këshillit të shkollës dhe e njëjta si dëshmi është dorëzuar në shtojcë me Vendimin.

Pas rishqyrtimit të përsëritur të të gjitha shkrimeve për lëndën e formaur në bazë të mendimit të marrë, Komisioni shtetëror konstaton se me ndërmarrjen e veprimeve nga ana e Këshillit të komunës, gjegjësisht me atë që është marrë vendim për ndërprerje të mandatit të për anëtar të këshillit të shkollës SHFK, janë ndërmarrë veprime me të cilat është menjanuar konflikti i interesave, dhe me atë është arritur efekti nga veprimi i Komisionit shtetëror, përshkak të së cilës është vendosur sipas dispozitave të këtij vendimi.

**KOMISIONI SHTETЁROР PЁR
PARANDALIM TЁ KORRUPSIONIT**
Kryetarё: Biljana Ivanovska

Pёrpunoi: E. N., bashkёpuntoг
Miratoi: S. P. D., anёtar i KSHPK

